



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 27 tetor 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1438_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenit 47 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Rregullës për vendosjen e të hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU);
- Kreun VII - Metodologjia për Strukturën Tarifore të "Rregullës për të Hyrat e FSHU" të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së;
- Vendimin V_1424_2021 të datës 7 tetor 2021 për aprovimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin e Shërbim Universal (FSHU/KESCO SH.A.);
- Kërkesën/propozimin e KESCO SH.A. – Furnizuesi me Shërbim Universal, për strukturën tarifore, të dërguar më datë 14 tetor 2021 në ZRRE, në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Elektrike,

në seancën e mbajtur më 27 tetor 2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN** - tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, që do të zbatohen nga i licencuari KESCO SH.A., aplikohen nga data 1 tetor 2021 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.
- II.** Struktura e tarifave me pakicë e energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal është në përputhje me Kreun VII - Metodologjia për Strukturën Tarifore të "Rregullës për të Hyrat e FSHU" të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së.

- III. Struktura e tarifave me pakicë e energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, e cila do të zbatohet nga Furnizuesi me Shërbim Universal (KESCO SH.A), është paraqitur në tabelën e mëposhtme të këtij Vendimi:

Tabela: Tarifat me pakicë të Energjisë Elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal:

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Tarifa
1	35 kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		11.19
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		5.85
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	4.92
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.16
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.67
2	10 kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		4.62
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.04
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	5.73
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.69
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.67
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët me energji reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.57
		Fuqia e angazhuar	€/kW		2.97
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.69
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.96
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.67
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.97
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	8.83
			€/kWh	Tarifë e Lartë	10.71
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Ulët	5.30
5	0.4kV matësi 2 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.75
				€/kWh	Tarifë e Ulët
6	0.4kV matësi 1 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh		5.32
7	0.4kV (familjarë pa matës)	Konsumi i vlerësuar:			
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
8	Ndrëqimi Publik	Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë mesatare	6.75
			€/kWh	Tarifë e vetme	9.24
<p>Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë periudhës 1 tetor deri më 31 mars Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 08:00 - 23:00 gjatë periudhës 1 prill deri më 30 shtator Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korespondon me $\cos(\Phi) < 0.95$</p>					

ARSYETIM

- ✚ ZRRE më datë 14 tetor 2021 ka pranuar nga KESCO SH.A, propozimin për Tarifat me pakicë të Energjisë Elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal . Propozimi i KESCO SH.A për tarifin e konsumatorëve me të drejtë të furnizimit me Shërbim Universal, është i bazuar në vendimin e ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU, V_1424_2021. Tarifin e propozuar nga KESCO janë kalkuluar në pajtueshmëri me Rregullën për të Hyrat e FSHU-së, konkretisht me Kreun VII - Metodologjia për Strukturën Tarifore të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së;
- ✚ Tarifin e propozuar nga KESCO, reflektojnë kostot e përgjithshme të furnizimit të konsumatorëve me shërbim universal, ku përfshihen kostot e energjisë elektrike me shumicë, kostot e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes dhe kostot direkte të FSHU-së.
- ✚ Tarifin e me pakicë për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal janë kategorizuar sipas grupeve tarifore në pajtueshmëri me Rregullën për të Hyrat e FSHU-së, përkatësisht me Kreun VII të Metodologjisë për Strukturën Tarifore. Kjo mundëson që secili grup tarifor të bartë kostot e shkaktuara.
- ✚ Vendimin V_1424_2021 të datës 7 tetor 2021 për aprovimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin e Shërbim Universal (FSHU/KESCO SH.A.);
- ✚ ZRRE me rastin e përcaktimit të tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, ka marrë parasysh dokumentet që janë përgatitur, lëshuar dhe publikuar në faqen zyrtare të ZRRE-së, si në vijim:
 - Aplikacionin e Furnizuesit me Shërbim Universal KESCO SH.A (FSHU) për kërkesën e të Hyrave të Lejuara Maksimale, të dorëzuar më datën 8 mars 2021;
 - Aplikacionin e Operatorit Sistemit të Shpërndarjes – KEDS SH.A (OSSH) për të Hyrat e Lejuara Maksimale, të dorëzuar me datën 8 mars 2021 në ZRRE;
 - Aplikacionin e Operatorit Sistemit të Transmetimit dhe Tregut – KOSTT SH.A (OST/OT) për të Hyrat e Lejuara Maksimale, të dorëzuar me datën 27 janar 2021 në ZRRE;
 - Raport Konsultativ - Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për FSHU (Prill 2021 - mars 2022), i publikuar më datë 24 gusht 2021;
 - Raport Konsultativ - Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KOSTT (viti relevant tarifor 2021), i publikuar më 24 gusht 2021;
 - Raport Konsultativ - Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KEDS (viti relevant tarifor 2021), i publikuar më 24 gusht 2021;

- Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të FSHU, Përgjigjet ndaj Komenteve (viti relevant tarifor 2021), i publikuar më 8 tetor 2021;
 - Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OST/OT-së, Përgjigjet ndaj Komenteve (viti relevant tarifor 2021), i publikuar më 8 tetor 2021; dhe
 - Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së, Përgjigjet ndaj Komenteve (viti relevant tarifor 2021), i publikuar më 8 tetor 2021.
 - Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, i cili dhe do të zbatohet nga KESCO SH.A. - Furnizuesi i Shërbimit Universal(FSHU), duke filluar nga data 1 tetor 2021 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, tridhjetë (30) ditë, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Bordi i Rregullatorit:


 Ymer Fejzullahu, Kryesues


 Selman Hoti, anëtar


 Izet Rushiti, anëtar


 Lutfije Dervishi, anëtare


 Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Furnizuesit me Shërbim Universal (KESCO SH.A), dhe
- Arkivit të ZRRE-së.